

Departamenti për Monitorim

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor - Korrik 2008

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport mujor nënvizon shkelje të ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe fokusohet në dy çështje:

1. caktimin e paraburgimit pa dëgjim në praninë e të pandehurit:

dhe

2. dështimin e gjykatave për të mbajtur procesverbale të sakta gjyqësore

1. Caktimi i paraburgimit pa dëgjim në praninë e të pandehurit shkel të drejtën për liri dhe ligjin vendor

OSBE është e brengosur se në disa raste të monitoruara gjykatat kanë caktuar paraburgim pa mbajtur seancë dëgjimore në prezencë të personit të arrestuar.

Sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, çdo person nën arrest ka të drejtë të “sillet shpejt para gjyqtarit.”¹ Andaj, i pandehuri duhet të paraqitet fizikisht para gjyqtarit, zakonisht gjatë “seancës dëgjimore.”²

E drejta e secilit person të arrestuar për t’u sjellur fizikisht pranë gjyqtarit paraqet mekanizëm mbrojtës kundër keqtrajtimit policor dhe kundër pretendimeve arbitrare të fuqive shtetërore. Ajo po ashtu siguron që çdo person i arrestuar të ketë mundësinë ta kundërshtoj privimin e tij apo saj nga liria.³

Ligji vendor parasheh garanci të ngjashme. Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, paraburgimi mund të caktohet vetëm pas dëgjimit.⁴ Personi i arrestuar duhet të silltet para gjyqtarit të procedurës paraprake dhe të informohet mbi të drejtat e tij/saj.⁵ Avokati mbrojtës duhet të jetë prezent gjatë dëgjimit,⁶ dhe të pandehurit duhet t’i jepet mundësi që t’i përgjigjet arsyeve të prokurorit për çfarë ka kërkuar paraburgim.⁷

¹ Neni 9(3) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Neni 5(3) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përdorin një gjuhë identike: “Çdo kush që arrestohet ose paraburgoset [mbi akuza penale] do të silltet shpejt para gjyqtarit ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ekzekutuar pushtet ligjor dhe do të ketë të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme ose për t’u liruar [...]”

² Shih Nenin 282, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003, (“Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale”). Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e bën të qartë se kur prokurorët kërkojnë caktim të paraburgimit kundër një personi “seanca dëgjimore është e obligueshme” (shih, p.sh. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Wloch kundër Polonisë*, 27785/95, Aktgjykim, 19 tetor 2000, paragrafi 126). Gjykata gjithashtu gjeti shkelje të Nenit 5(3) të Konventës edhe kur kërkesa për arrest ishte lëshuar nga gjykata në prani të avokatit mbrojtës, por pa sjelljen e vet të pandehurit pranë gjykatës (shih *McGoff kundër Suedisë*, 9017/80, Aktgjykim, 26 tetor 1984, paragrafi 27).

³ Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “Vet qëllimi i nenit 5 [është] të mbrohet individi nga arbitrazhet” (*Kurt kundër Turqisë*, 15/1997/799/1002, Aktgjykim, 25 maj 1998, paragrafi 122).

⁴ Shih Nenin 282(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

⁵ Neni 282(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

⁶ Neni 282(3) Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Sipas Nenit 282(4), në qoftë se i pandehuri nuk angazhon avokat mbrojtës, gjykata duhet ta caktojë një sipas detyrës zyrtare.

⁷ Neni 282(5), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

Përkundër këtyre dispozitave ligjore, OSBE ka vërejtur raste ku gjyqtarët kanë caktuar paraburgim pa mbajtur seancë dëgjimore në prani të të pandehurit ose avokatit të tij.

Në një rast pranë një gjykate në regjionin e Prizrenit, me 11 maj 2008 policia arrestoi një të pandehur mbi akuza të lëndimit të rëndë trupor.⁸ Me 14 maj 2008, prokurori ngriti aktakuzë që përmbante kërkesën për arrest. Në të njëjtën datë, kolegji i përbërë prej tre gjyqtarëve urdhëroi paraburgim për një muaj. As i pandehuri e as mbrojtësi i tij nuk u morën në pyetje.

Në një rast pranë gjykatës së njëjtë në regjionin e Prizrenit, me 4 janar 2008 policia arrestoi një të pandehur për shkak se kinse kishte sulmuar personat zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.⁹ Me 7 janar 2008 prokurori ngriti aktakuzë që përmbante kërkesë për caktim të paraburgimit. Në po të njëjtën datë, gjykata pa mbajtur seancë dëgjimore në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës të tij, lëshoi aktvendim me të cilin urdhëroi një muaj paraburgim.

Në një rast pranë një gjykate komunale në regjionin Prishtinë/Priština, me 15 korrik 2008 policia arrestoi një të pandehur mbi akuza të vjedhjes së rëndë,¹⁰ shkaktim të lëndimit të lehtë trupor,¹¹ dhe dëmtim të pronës së luajtshme.¹² Në të njëjtën datë, prokurori e mori në pyetje të pandehurin dhe ngriti aktakuzë me propozim për caktim të paraburgimit. Kolegji i gjykatës komunale caktoi një muaj paraburgim, pa e dëgjuar të pandehurin ose mbrojtësin e tij.

Në rastet e sipërme, gjykatat urdhëruan paraburgim pa seancë dëgjimore në prani të të pandehurve ose avokatëve mbrojtës. Kjo ka shkelur ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Disa gjyqtarë dhe prokurorë kanë argumentuar se gjykatat nuk kanë nevojë të dëgjojnë personin e arrestuar (ose avokatin mbrojtës) në qoftë se kërkesa e prokurorit për paraburgim ndodhet në aktakuzë¹³ të ushtruar para skadimit të afatit 72 orësh për arrest policor.¹⁴ Kushtimisht, kolegji i përbërë prej tre gjyqtarëve duhet të vendos “në letër” bazuar në propozimin e prokurorit që përfshihet në aktakuzë. Andaj, sjellja fizike e personit të arrestuar para autoritetit gjyqësor nuk është e domosdoshme.

Megjithatë, ky interpretim i ligjit bie në konflikt me standardet ndërkombëtare dhe ligjin vendor, të cilët parashohin seancë dëgjimore për paraburgim në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës të tij/saj. Përfshirja e kërkesës për paraburgim në aktakuzë nuk i liron autoritetet gjyqësore nga mbajtja e seancës lidhur me kërkesën për paraburgim. Neni

⁸ Neni 154, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm Penal”).

⁹ Neni 317, Kodi i Përkohshëm Penal.

¹⁰ Neni 253(1)(1), Kodi i Përkohshëm Penal.

¹¹ Id., Neni 153(2).

¹² Id., Neni 260(1).

¹³ Siç lejohet me Nenin 306(4) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

¹⁴ Neni 212(4), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

306(4) i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale nuk pezullon kushtin e përgjithshëm nga Neni 282 me të cilin paraburgimi mund të caktohet vetëm pas seancës dëgjimore.

Dështimi për të sjell personat e arrestuar para gjyqtarit shkel të drejtën fundamentale të tyre për liri. Veç kësaj, këshillimi gjyqësor i bërë pa dëgjimin e të pandehurit gjithashtu përbën shkelje të së drejtës për vetëmbrojtje dhe parimin e barazisë së armëve.¹⁵

Rrjedhimisht, këndvështrimi i OSBE-së është se:

- Gjykatat duhen që gjithmonë të caktojnë dhe të mbajnë seancë dëgjimore mbi paraburgim në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës para se të vendosin mbi propozimin e prokurorit për paraburgim kundër personit të arrestuar.
- Në kontekstin e rastit në fjalë ose çfarëdo paqartësie lidhur me çështjet e paraburgimit, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të lëshojë një vendim për të qartësuar se Neni 306(4) i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale do të lexohet me Nenin 282 dhe 287(1), dhe nuk i liron gjykatat nga mbajtja e seancës dëgjimore për paraburgim (ku do të përfshihen i pandehuri dhe avokati mbrojtës) para se të vendosin mbi caktimin e paraburgimit.

2. Dështimi i gjykatave për të mbajtur procesverbale të sakta gjyqësore shkel ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Dështimi i vazhdueshëm i gjykatave për të mbajtur procesverbale të sakta¹⁶ të procedurave gjyqësore shkel ligjin vendor dhe ndikon në të drejtat e parapara me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për derisa OSBE ka raportuar më parë mbi këtë çështje, problemi vazhdon andaj edhe meriton që prapë të raportohet mbi temën.¹⁷

Gjykatat duhet të mbajnë procesverbale të shkruara mbi të gjitha veprimet që merren në seancat gjyqësore,¹⁸ duke përfshirë emrin, përbërjen e gjykatës, “vendin ku veprimi është

¹⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur se: “Nga këndvështrimi i ndikimit dramatik së privimit nga liria mbi të drejtën fundamentale të personit që është në pyetje, procedura [që ka për qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit të një personi] duhet që në parim, në shkallën më të lartë të mundshme nën rrethanat e hetimeve që janë duke u bërë, të jetë në përputhje me kushtet themelore të gjyqimit të drejtë” (*Shishkov kundër Bullgarisë*, 38822/97, Aktgjykim, 9 janar 2003, paragrafi 77). Kushtet për gjykim të drejtë përfshijnë parimet e procedurës kontradiktore dhe barazisë së armëve (Shih Neni 6, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

¹⁶ Përkthimi kryesor jozyrtar i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nga Qendra Juridike e Kosovës i referohet dokumentit se kush çka tha dhe kush ishte prezent gjatë seancës gjyqësore si “angl. records.” Kushtimisht, termi më i saktë është “ang. minutes,” i cili përdoret në tërë raportin mujor. Shih definicionin e “minutes” në fjalorin “Black’s Law” (Edicioni i tetë) dhe “Oxford Advance Learner’s Dictionary” (Edicioni i gjashtë, nga Sally Wehmeier).

¹⁷ Shih Raportin Mujor të Seksionit për Monitorimin e Sistemit Juridik të OSBE-së, tetori 2007 (“Dështimi në përpilimin e procesverbaleve të sakta dhe të plota në procedurën civile përbën shkelje të ligjit vendor”).

¹⁸ Neni 123.1, Ligji mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nr. 4/77; Neni 182, Rregullat mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 21/78. Gjykata Supreme udhëzon gjykatat mbi mbajtje të procesverbaleve. Neni 31, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta. Ligji mbi Procedurën Kontestimore gjithashtu adreson mbajtjen e procesverbaleve gjatë këshillimit dhe votimit të kolegjit, por kjo çështje nuk adresohet këtu. Shih Nenin 128.

marrë,” data dhe koha, “emërtimi i objektit së kontestit,” dhe emrat e të pranishmëve.¹⁹ Gjatë procedurës, kryetari i kolegjit “me zë i dikton procesmbajtëses se çka të fus në [procesverbal].”²⁰ Procesverbali duhet të nënvizojë se çfarë veprimi është ndërmarr dhe a ka qenë seanca publike si shtesë ndaj asaj se a i ka informuar gjykata palët mbi të drejtën për përdorim të gjuhës së tyre.²¹ Deklaratat, mocionet, dhe dëshmitë e propozuara dhe të pranuar të palëve të përfshira si dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe të ekspertëve duhet të përfshihen në procesverbal si shtesë ndaj çfarëdo vendimi të gjykatës të marur gjatë seancës.²² Procesverbali gjithashtu duhet të “nënvizojë deklaratat ose komunikimet më të rëndësishme të cilat palët ose pjesëmarrësit tjerë kanë dhënë *jashtë* seancës.” (theks i shtuar).²³ Për “deklarata dhe shpallje më pak të rëndësishme,” gjykatat duhet të bëjnë “shënim zyrtar.”²⁴ Procesverbali duhet të “mbahet në mënyrë adekuate.”²⁵ Ato nuk mund të shlyhen, të përmirësohen ose të ndryshohen dhe çdo gjë që është korrigjuar duhet të jetë e lexueshme.²⁶

Palët kanë të drejtë për të lexuar dhe komentuar procesverbalin, për derisa pjesëmarrësit tjerë jo-palë mund të lexojnë dhe komentojnë vetëm pjesën e procesverbalit ku përfshihen deklaratat e tyre.²⁷ Çfarëdo korrigjime ose shtesa janë të përfshira në fund të procesverbalit. Korrigjimet ose shtesat e kërkuara të cilat nuk aprovohen mund të futen në procesverbal me kërkesë të personit që ka parashtruar ato.²⁸ Kryetari i kolegjit, procesmbajtësi, palët apo përfaqësuesit e tyre dhe përkthyesi duhet ta nënshkruajnë procesverbalin.²⁹ Dëshmitarët, përfshirë këtu edhe ekspertët gjithashtu nënshkruajnë deklaratat e tyre të dhëna pranë gjykatës.³⁰

Veç kësaj, mbajtja e procesverbalit të saktë promovon të drejtën për ankesë. Pasi që gjykatat në shkallë të dytë shfrytëzojnë procesverbalet e shqyrtimit kryesor,³¹ gjykata ankimore që shqyrton procesverbalin e gjykatës më të ulët nuk mund të bëjë vlerësim

¹⁹ Neni 124, Ligji mbi Procedurën Kontestimore. Shih gjithashtu Nenin 7.2, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta (“Shpallja e përbërjes së kolegjit [sic] të gjyqtarëve” siguron publicitet të punës së gjykatave).

²⁰ Neni 126, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

²¹ Neni 124, Ligji mbi Procedurën Kontestimore; Neni 13, Rregullat mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave.

²² Neni 124, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

²³ Id. Neni 123.2.

²⁴ Id. Ligji nuk definon “më pak të rëndësishme” dhe “më të rëndësishme”, që mund të qoj në konfuzion sa i përket interpretimit të duhur.

Në rast kur me ligj kërkohet që të mbahet procesverbali, një “shënim zyrtar” mund të bëhet. Shënimi duhet të përfshijë veprimin zyrtar dhe datën e vendin ku është bërë. “Kjo në veçanti është valide për marrjen e deklaratave [sic] ose të dhënave me më pak rëndësi nga palët ose për njoftime të ndryshme [sic] të bëra nga palët.” Neni 183, Rregullat mbi Aktivitetet e Brendshme të Gjykatave.

Kushte tjera aplikohen në procedurat mbi “kontestet me vlerë të ulët.” Neni 463, Ligji mbi Procedurën Kontestimore. Si shtesë ndaj informacionit të kërkuar me Nenin 124, procesverbalet gjyqësore duhet gjithashtu të përmbajnë: (1) “[D]eklaratat e palëve të cilat janë me rëndësi, veçanërisht ato në bazë të të cilave njëra apo pala tjetër, tërësisht apo pjesërisht pranon padinë, ose mohon padinë ose ankesën, ose ndryshon apo tërheq padinë [sic];” (2) “përmbajtjen e dëshmimeve të pranuar;” (3) “vendimet ndaj të cilave është e lejuar ankesa, dhe të cilat janë lexuar gjatë gjykimit [sic];” dhe (4) “se a kanë qenë të pranishme palët gjatë leximit të aktgjykimit, dhe po që se kanë qenë, a kanë qenë ato të njoftuara lidhur me kushtet e ankesës.”

²⁵ Neni 125, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

²⁶ Id.

²⁷ Id. Neni 126.

²⁸ Id.

²⁹ Id. Neni 127.

³⁰ Id.

³¹ Id. Neni 363.

korrekt të procedurës së gjykatës më të ulët në qoftë se shkresat e lëndës përmbajnë informata të pasakta.³²

Saktësia e procesverbalit gjyqësor gjithashtu përfshin të drejtën për “dëgjim korrekt dhe publik” të garantuar sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.³³

Përkundër këtyre kërkesave, gjykatat vazhdimisht dështojnë të mbajnë procesverbale të sakta të procedurave:

Në një rast të anulimit të kontratave në regjionin Mitrovicë/Mitrovica, procesverbali i seancës nga nëntori 2007 tregon praninë e tij, edhe pse ai kishte vdekur një ditë më parë.

Në një rast shkurorëzimi në regjionin e Prizrenit, në procesverbalet e dy seancave të mbajtura në prill 2007 kanë përmbajtje të pasaktë. Në një seancë, në procesverbal thuhet se gjykata tentoi të pajtojë palët siç kërkohet nga ligji i aplikueshëm për shkurorëzime. Megjithatë, paragrafi në vazhdim i procesverbalit të datës së njëjtë shënon se i padituri nuk ishte prezent. Në një seancë të mëvonshme në të njëjtin rast, procesverbali tregon praninë e dy gjyqtarëve porotë të cilët nuk kishin marr pjesë. Procesverbali gjithashtu nuk veçon se a ishte seanca a hapur për publikun, që është e rëndësishme së veçantë në procedurën e shkurorëzimit që sipas ligjit të Kosovës duhet të jetë e mbyllur.

Në një rast të kompensimit të dëmit pranë një gjykate në regjionin Pejë/Peć, procesverbali nga një seancë e mbajtur në dhjetor 2007 tregon gjyqtarët porotë që mungonin, si të pranishëm.³⁴

Në drejtim të dështimit të vazhdueshëm për të mbajtur procesverbale të sakta të procedurave gjyqësore, pozicioni i OSBE-së është se:

³² Neni 6.1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk krijon menjëhershëm të drejtën për ankesë në rastet civile. Neni 2 i Protokollit të Shtatë të Konventës dhe Neni 14.5 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike parashohin të drejtën për ankesë vetëm në rastet penale. Megjithatë, në të shumtën e vendeve që janë palë në Konventë, ekziston mundësia për t'u ankuar kundër vendimeve civile gjyqësore në mënyrë që palëve t'u ofrohet mbrojtje ligjore shtesë. Por shih *Delcourt kundër Belgjikës*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2689/65, Aktgjykimi, 17 janar 1970, paragrafi 25; *Hoffmann kundër Gjermanisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 34045/96, Aktgjykimi, 11 tetor 2001, paragrafi 65.

³³ Neni 6, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shih *Axen kundër Gjermanisë*, 11 tetor 2001, 8273/78, Aktgjykimi, 8 dhjetor 1983, paragrafi 25 (“Karakteri publik i procedurës pranë organit gjyqësor i referuar në neni 6 paragrafin 1 [të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] mbron palët ndaj administrimit të drejtësisë në fshehtësi pa vlerësim të kujdesshëm publik; është gjithashtu një nga mjetet përmes të cilit mund të mirëmbahet besimi superior dhe inferior në gjykata. Duke e ndarë drejtësinë në mënyrë të dukshme, publiciteti i kontribuon arritjes së qëllimit të nenit 6 paragrafit 1, më hollësisht gjykimit të drejtë, garantimi i së cilit është një nga parimet fundamentale të cilësdo shoqërie demokratike.”) Shih gjithashtu Nenin 7, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta “Puna e gjykatave është publike,” dhe publiciteti sigurohet përmes “gjykimeve të hapura.”

³⁴ Në një seancë tjetër në të njëjtin rast, procesverbali nënvizon praninë e përfaqësuesit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe të monitoruesit të OSBE-së. Pasi që ky ishte rast i hapur për publikun, kushtimisht, emërtimi i anëtarëve individual të pranishëm në publik nuk është dashur të paraqitet në procesverbal.

- Gjyqtarët, procesmbajtësit, avokatët dhe profesionistët tjerë ligjor duhet t'i rishikojnë procesverbalet për së afërmi se a janë të sakta, para se t'i nënshkruajnë ato.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet t'i udhëzoj gjyqtarët mbi kërkesat ligjore që lidhen me mbajtjen e procesverbaleve.
- Oda e Avokatëve të Kosovës duhet t'i arsimojë avokatët mbi rëndësinë që të sigurohet se procesmbajtësit të përpilojnë procesverbale të sakta gjyqësore.